

VENDIM
Nr. 562, datë 22.8.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 132, DATË 22.2.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (KULTURA BUJQËSORE DHE
DRUFRUTORË), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN – VLORË
(SEKSIONI I PARË)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr. 132, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Shuma e palikuiduar prej 6 336 392 (gjashtë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtëmijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekësh nga vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 6 398 024 (gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e njëzet e katër) lekësh, do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha